



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 540/7 prot.

Datë 08.04.2024

V E N D I M
Nr. 357/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.04.2024 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

“Vendim për mbylljen e çështjes, për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “KLAME” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-96233-02-23-2024, me objekt: “Blerje Pajisje Mobilimi”, me fond limit 28,841,800.00 lekë (pa TVSh), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 13.03.2024 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Posta Shqiptare.

Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-96233-02-23-2024, me objekt: “Blerje Pajisje Mobilimi”, me fond limit 28,841,800.00 lekë (pa TVSh), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 13.03.2024, nga autoriteti kontraktor, Sh.A Posta Shqiptare.

Ankimues:

Operatori ekonomik “KLAME” SHPK, me Nipt (K21518003F), me adresë: Rruga “Gani Kryeziu”, Nr.23, Kati i dytë, Njesia Administrative 11, Kodër Kamëz.

Autoriteti Kontraktor:

Sh.A Posta Shqiptare, me adresë: Rr.“Reshit Çolloku”, Nr. 4 Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për

miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesat e paraqitura nga operatorët ekonomikë ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomikë ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Operatori ekonomikë ankimues, ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 26.02.2024, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-96233-02-23-2024, me objekt: “Blerje Pajisje Mobilimi”, me fond limit 28,841,800.00 lekë (pa TVSh), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 13.03.2024, nga autoriteti kontraktor, Sh.A Posta Shqiptare.

II.2. Në datën 04.03.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr.A/2024/3858 dhe nr.540/2024 prot., i operatorit ekonomik “Klame” SHPK, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi..

II.2.1. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.2.2. Në datën 07.03.2024, operatori ekonomik “KLAME” SHPK, ka dorëzuar pranë KPP-së, Formularin e ankesës.

II.2.3. Me anë të shkresës nr. 391/5 prot., datë 08.03.2024, protokolluar me tonën me nr. 540/3 prot., datë 11.03.2024, me objekt “*Kthim - Pergjigje*”, dhe shkresës nr. 391/8 prot, datë 11.03.2024, protokolluar me tonën nr. 540/4, datë 12.03.2024, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, shkresat mbi shqyrtimin e ankesës, ku konstatohet, se e ka pranuar pjesërisht atë, duke publikuar shtojcën e re, si më poshtë:

“[...] Në shtojcën 7, Formulari i Kriteve të Veçanta për kualifikim, të Dokumenteve standarde të tenderit, bëhen modifikimet si vijon:

Pika 2.1. b, ISHTE:

b. Sigurimin e Ofertës, në vlerën 2576,836 Lek (pesëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e tridhjetë e gjashtë).

Pika 2.1. b, BËHET:

b. Sigurimin e Ofertës, në vlerën 576,836 Lek (pesëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e tridhjetë e gjashtë).

Pika 2.3.2 ISHTE:

2.3.2. *Operatori Ekonomik për të realizuar prodhimin/montimin dhe shpërndarjen e mallrave objekt prokurimi, si dhe shërbimin e transportit duhet të ketë të punësuar minimalisht një staf prej 10 (dhjetë) punonjësish. Për të plotësuar këtë kriter duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën jo më pak se 3 (tre) muajt e fundit të maturuara nga data e hapjes së tenderit, shoqëruar me listë pagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë të konfirmuara nga organet tatimore. Nga të cilët:*

1 arkitekt ose inxhinier druri - të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme CV, diplomë përkatëse,

- 2 shofer*
- 2 Marangoz, 1 saldator*

- Për punonjësit e punësuar shofer, të paraqitet kontrate pune përkatëse si dhe leje drejtimi për secilin.
- Për punonjësit e punësuar marangoz, të paraqitet kontratë pune përkatëse si dhe deshmitë e kualifikimit profesional teknik për secilin.
- Për punonjësit e punësuar saldator, të paraqitet kontratë pune përkatëse si dhe deshmitë e kualifikimit profesional teknik për secilin.

Pika 2.3.2 BËHET:

2.3.2. Operatori Ekonomik për të realizuar prodhimin/montimin dhe shpërndarjen e mallrave objekt prokurimi, si dhe shërbimin e transportit duhet të ketë të punësuar minimalisht një staf prej 10 (dhjetë) punonjësish. Për të plotësuar këtë kriter duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën jo më pak se 3 (tre) muajt e fundit të maturuara nga data e hapjes së tenderit, shoqëruar me listë pagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë të konfirmuara nga organet tatimore. Nga të cilët:

1 arkitekt ose inxhinier druri - të vërtetuar me diplomë përkatëse,

- 2 shofer
- 2 Marangoz, 1 saldator
- Për punonjësit e punësuar shofer, të paraqitet leje drejtimi për secilin.
- Për punonjësit e punësuar marangoz, të paraqitet deshmitë e kualifikimit profesional teknik për secilin.
- Për punonjësit e punësuar saldator, të paraqitet deshmitë e kualifikimit profesional teknik për secilin.

Pika 2.3.8 ISHTE:

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Certifikate ISO 14001-2015 ose ekuivalente** (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zërave të mallrave që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

Pika 2.3.8 Bëhet:

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Certifikate ISO 14001-2015 ose ekuivalente** (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zërave të mallrave që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes) **ose Lejes Mjedisore, e lëshuar nga organet kompetente.**

Pika 2.3.10, ISHTE:

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikate Për sistemin e integruar të mënaxhimit **BS PAS 99:2012 ose ekuivalente** (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zerave të mallarave që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt - marrëveshjes).

Pika 2.3.10, Bëhet:

Pika 2.3.10 hiqet si kriter kualifikues.

Pika 2.3.11 ISHTE:

2.3.11 Operatori ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikatat e cilësisë dhe raportet e testimi të produktit, të vlefshme, si më poshtë:

- **Karrige zyre statike: SSH/ EN 1335-1:2020+A1:2022, SSH EN 1335-2:2018 e vlefshme ose ekuivalente**
- **Karrige rrotulluese (zyre): SSH/ EN 1335-1:2020+A1:2022, SSH EN 1335-2:2018, e vlefshme ose ekuivalente.**
- **Dollap (Raft) : SSH/ EN 14073-1:2004, EN 14073-3:2004 , SSH EN 14074:2004, e vlefshme ose ekuivalente.**
- **Dollap metalike: SSH/ EN 14073-3:2004, EN 14074:2004, e vlefshme ose ekuivalente.**

Certifikatat e cilësisë të produktit duhet të jenë të vlefshme për gjatë periudhës së realizimit të procedurës së prokurimit. Certifikatat e kërkuara duhet të jenë origjinale ose të njehsuara me origjinalin (kopje të noterizuara). Certifikatat e cilësisë duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet kur oferta dorëzohet nga një BOE, operatorët duhet të disponojnë certifikatat e kërkuara në përputhje me raportin e pjesëmarrjes në furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje.

Gjithashtu për të gjitha certifikatat e mësipërme, operatori ekonomik mund të paraqesë certifikata ekuivalente me të njëjtën performancë (qellim certifikues) ose të përditësuara me ato më sipër, sipas standarteve SSH/EN mbi konformitetin e standarteve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Pika 2.3.11 Bëhet:

2.3.11 Operatori ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikatat e cilësisë dhe raportet e testimi të produktit, të vlefshme, si më poshtë:

- **Karrige zyre statike: SSH/ EN 1335-1:2020+A1:2022, SSH EN 1335-2:2018 e vlefshme ose ekuivalente**

- *Karrige rrotulluese (zyre): SSH/ EN 1335-1:2020+AI:2022, SSH EN 1335-2:2018, e vlefshme ose ekuivalente.*
- *Dollap (Raft) : SSH/ EN 14073-1:2004, EN 14073-3:2004 , SSH EN 14074:2004, e vlefshme ose ekuivalente.*
- *Dollap metalike: SSH/ EN 14073-3:2004, EN 14074:2004, e vlefshme ose ekuivalente.*

Certifikatat e cilësisë së produktit duhet të jenë të vlefshme në momentin e dorëzimit dhe të hapjes të ofertave të procedurës së prokurimit. Certifikatat e kërkuara duhet të jenë origjinale ose të njehsuara me origjinalin (kopje e noterizuar). Certifikatat e cilësisë duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet kur oferta dorëzohet nga një BOE, operatorët duhet të disponojnë certifikatat e kërkuara në përputhje me raportin e pjesëmarrjes në furnizim, të përcaktuara në akt - marrëveshje.

Gjithashtu për të gjitha certifikatat e mësipërme, operatori ekonomik mund të paraqesë certifikata ekuivalente me të njëjtën performancë (qellim certifikues) ose të përditësuara me ato më sipër, sipas standardeve SSH/EN mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Shënim: Operatori ofertues, së bashku me dokumentacionin e sipërshënuar duhet të paraqesë të dhena të plota të Subjektit që lëshon certifikatat e cilësisë dhe raportet e testimit së produktit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e ti.

Kjo shtojcë e modifikimeve bëhet pjesë e dokumentacionit standard të tenderit.

Dokumentet e tjera të procedurës së prokurimit ngelen të pandryshuara.

Procedura ngelet e pezulluar në zbatim të nenit 112/2 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”. [...]

III

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur tyre si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e ankimuesit për modifikimin e dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Me anë të shkresës nr. nr. 391/5 prot., datë 08.03.2024 , protokolluar me tonën me nr. 540/3 prot., datë 11.03.2024, me objekt “Kthim - Pergjigje”, dhe shkresës nr. 391/8 prot, datë 11.03.2024, prtokolluar me tonën nr. 540/4, datë 12.03.2024, konstatohet, se autoriteti kontraktor ka pranuar pjesërisht atë, dhe ka publikuar shtojcën si më poshtë:

“[...]

Në shtojca 7, Formulari i Kritereve të Veçanta për kualifikim, të Dokumentave standarte të tenderit, bëhen modifikimet si vijon:

Pika 2.1. b, ISHTE:

b. Sigurimin e Ofertës, në vlerën 2576,836 Lek (pesëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e tridhjetë e gjashtë).

Pika 2.1. b, BËHET:

b. Sigurimin e Ofertës, në vlerën 576,836 Lek (pesëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e tridhjetë e gjashtë).

Pika 2.3.2 ISHTE:

2.3.2. Operatori Ekonomik për të realizuar prodhimin/montimin dhe shpërndarjen e mallrave objekt prokurimi, si dhe shërbimin e transportit duhet të ketë të punësuar minimalisht një staf prej 10 (dhjetë) punonjësish. Për të plotësuar këtë kriter duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën jo më pak se 3 (tre) muajt e fundit të maturuara nga data e hapjes së tenderit, shoqëruar me listë pagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë të konfirmuara nga organet tatimore. Nga të cilët:

1 arkitekt ose inxhinier druri - të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme CV, diplomë përkatëse,

- 2 shofer*
- 2 Marangoz, 1 saldator*

- Për punonjësit e punësuar shofer, të paraqitet kontrate pune përkatëse si dhe leje drejtimi për secilin.*
- Për punonjësit e punësuar marangoz, të paraqitet kontratë pune përkatëse si dhe deshmitë e kualifikimit profesional teknik për secilin.*
- Për punonjësit e punësuar saldator, të paraqitet kontratë pune përkatëse si dhe deshmitë e kualifikimit profesional teknik për secilin.*

Pika 2.3.2 BËHET:

2.3.2. Operatori Ekonomik për të realizuar prodhimin/montimin dhe shpërndarjen e mallrave objekt prokurimi, si dhe shërbimin e transportit duhet të ketë të punësuar minimalisht një staf prej 10 (dhjetë) punonjësish. Për të plotësuar këtë kriter duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën jo më pak se 3 (tre) muajt e fundit të maturuara nga data e hapjes së tenderit,

shoqëruar me listëpagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë të konfirmuara nga organet tatimore. Nga të cilët:

- 1 arkitekt ose inxhinier druri - të vërtetuar me diplomë përkatëse,
- 2 shofer
- 2 Marangoz, 1 saldator

- Për punonjësit e punësuar shofer, të paraqitet leje drejtimi për secilin.
- Për punonjësit e punësuar marangoz, të paraqitet deshmitë e kualifikimit profesional teknik për secilin.
- Për punonjësit e punësuar saldator, të paraqitet deshmitë e kualifikimit profesional teknik për secilin.

Pika 2.3.8 ISHTE:

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Certifikatë ISO 14001-2015 ose ekuivalente** (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zërave të mallrave që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

Pika 2.3.8 Bëhet:

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Certifikate ISO 14001-2015 ose ekuivalente** (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zërave të mallrave që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes) **ose Lejes Mjedisore, e lëshuar nga organet kompetente.**

Pika 2.3.10, ISHTE:

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Certifikate Për sistemin e integruar të mënaxhimit BS PAS 99:2012 ose ekuivalente** (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zërave të mallrave që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

Pika 2.3.10, Bëhet:

Pika 2.3.10 hiqet si kriter kualifikues.

Pika 2.3.11 ISHTE:

2.3.11 Operatori ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikatat e cilësisë dhe raportet e testimi të produktit, të vlefshme, si më poshtë:

- **Karrige zyre statike: SSH/ EN 1335-1:2020+A1:2022, SSH EN 1335-2:2018 e vlefshme ose ekuivalente**
- **Karrige rrotulluese (zyre): SSH/ EN 1335-1:2020+A1:2022, SSH EN 1335-2:2018,e vlefshme ose ekuivalente.**
- **Dollap (Raft) : SSH/ EN 14073-1:2004, EN 14073-3:2004 , SSH EN 14074:2004, e vlefshme ose ekuivalente.**
- **Dollap metalike: SSH/ EN 14073-3:2004, EN 14074:2004, e vlefshme ose ekuivalente.**

Certifikatat e cilësisë së produktit duhet të jenë të vlefshme për gjatë periudhës së realizimit të procedurës së prokurimit. Certifikatat e kërkuara duhet të jenë origjinale ose të njehsuara me origjinalin (kopje e noterizuar). Certifikatat e cilësisë duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet kur oferta dorëzohet nga një BOE, operatorët duhet të disponojnë certifikatat e kërkuara në përputhje me raportin e pjesëmarrjes në furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje.

Gjithashtu për të gjitha certifikatat e mësipërme, operatori ekonomik mund të paraqesë certifikata ekuivalente me të njejtën performancë (qellim certifikues) ose të përditësuara me ato më sipër, sipas standarteve SSH/EN mbi konformitetin e standarteve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Pika 2.3.11 Bëhet:

2.3.11 Operatori ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikatat e cilësisë dhe raportet e testimi të produktit, të vlefshme, si më poshtë:

- **Karrige zyre statike: SSH/ EN 1335-1:2020+A1:2022, SSH EN 1335-2:2018 e vlefshme ose ekuivalente**
- **Karrige rrotulluese (zyre): SSH/ EN 1335-1:2020+A1:2022, SSH EN 1335-2:2018,e vlefshme ose ekuivalente.**
- **Dollap (Raft) : SSH/ EN 14073-1:2004, EN 14073-3:2004 , SSH EN 14074:2004, e vlefshme ose ekuivalente.**
- **Dollap metalike: SSH/ EN 14073-3:2004, EN 14074:2004, e vlefshme ose ekuivalente.**

Certifikatat e cilësisë së produktit duhet të jenë të vlefshme në momentin e dorëzimit dhe të hapjes të ofertave të procedurës së prokurimit. Certifikatat e kërkuara duhet të jenë origjinale ose të njehsuara me origjinalin (kopje e noterizuar). Certifikatat e cilësisë duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet kur oferta dorëzohet nga një BOE, operatorët duhet të disponojnë

certifikatat e kërkuara në përputhje me raportin e pjesëmarrjes në furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje.

Gjithashtu për të gjitha certifikatat e mësipërme, operatori ekonomik mund të paraqesë certifikata ekuivalente me të njejtën performancë (qellim certifikues) ose të përditësuara me ato më sipër, sipas standarteve SSH/EN mbi konformitetin e standarteve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Shënim: Operatori ofërtues, së bashku me dokumentacionin e sipërshënuar duhet të paraqesë të dhena të plota të Subjektit që lëshon certifikatat e cilësisë dhe raportet e testimit së produktit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e ti.

Kjo shtojcë e modifikimeve bëhet pjesë e dokumentacionit standart të tenderit.

Dokumentat e tjera të procedurës së prokurimit ngelen të pandryshuara.

Procedura ngelet e pezulluar në zbatim të nenit 112/2 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”

III.1.4. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.

III.1.5. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i cili parashikon shprehimisht se : Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i

afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

Për këtë arsye, KPP do të mbyllë shqyrtimin e çështjes në lidhje me këto pjesë të pranuar nga autoriteti kontraktor, për ankesën nr. 540 prot, datë 04.03.2024, të operatorit ekonomik “KLAME” SHPK.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “KLAME” SHPK ku kërkon:

Lidhur me kërkesën e Ak se :

2.3.3. *Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë në pronësi ose në përdorim të paktën 1 (një) ambient për prodhimin ose magazinimin e mallrave objekt - prokurimi.*

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Kërkesa e mesiperme është teresisht e panevojshme për sa kohë operatorët ekonomike kanë lejen e ushtrimit të aktivitetit dhe eksperiencën e duhur që jep garanci për realizimin me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor nuk mund të kërkojë dokumentacion i cili ka shërbyer për leshimin e dokumentit final që ka të bëjë me lejen e ushtrimit të aktivitetit. Përse me siper, kërkojmë heqjen e kësaj kerkese si e pa nevojshme dhe e pa argumentuar.

III.2.1 Në dokumentet e tenderit, Shtojca 7, “2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT”, autoriteti kontraktor ka parashikuar;

2.3.3. *Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë në pronësi ose në përdorim të paktën 1 (një) ambient për prodhimin ose magazinimin e mallrave objekt prokurimi.*

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoriteti Kontraktor

III.2.2 Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikon shprehimisht se:

1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

a) *përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*

b) *gjendjen ekonomike dhe financiare;*

c) *aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

III.2.3 Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se:

1. *Qëllim i këtij ligji është:*

a) *të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*

- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.2.4 Ndërsa në nenin 3 pika 2 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, thuhet: “2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar”.

III.2.5 Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit.

Referuar kriterëve të kualifikimit, konstatohet, se është kërkuar që “Kërkesa e mesiperme është teresisht e panevojshme për sa kohe operatorët ekonomike kanë lejen e ushtrimit të aktivitetit dhe eksperiencën e duhur që jep garanci për realizimin me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor nuk mund të kërkojë dokumentacion i cili ka shërbyer për leshimin e dokumentit final që ka të bëjë me lejen e ushtrimit të aktivitetit. Për sa me sipër, kërkojnë heqjen e kësaj kerkese si e panevojshme dhe e paargumentuar.”.

Sa më sipër, referuar specifitimeve teknike, sasisë dhe grafikut të lëvrimit të mallit, si dhe termave të referencës, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kërkesa e autoritetit kontraktor për një 1 (një) ambient, për prodhimin ose magazinimin e mallrave objekt - prokurimi është një kërkesë e ekzagjeruar, jo në përputhje me objektin dhe natyrën e objektit të prokurimit, e cila kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi. Gjithashtu, autoriteti kontraktor, ka të drejtë të kërkojë furnizime të pjesshme nga operatori ekonomik fitues, dhe është detyrë e këtij të fundit menaxhimi i kërkesave dhe përmbushja në kohë e tyre, akoma më tej plotësimi i këtij kriteri nuk është tregues mbi krijimin e besueshmërisë nga ana e autoritetit kontraktor për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për përmbushjen me sukses të kontratës.

Referuar DST dhe kriterëve të përcaktura nga ana e autoritetit kontraktor vërejmë se garancinë për zbatimin me sukses të kontratës, autoriteti e siguron nëpërmjet kriterëve të tjera të kualifikimit sikurse është “përvoja e mëparshme e realizuar”... Për autoritetin kontraktor e rëndësishme është që operatori ekonomik të vërtetojë, se gëzon kapacitetet e nevojshme për realizimin e furnizimit dhe nuk mund të përcaktojë kriterë në tejkalim të natyrës dhe objektit të prokurimit. Sqarojmë gjithashtu, se dokumentet e tenderit dhe kriteret për kualifikim, duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik, në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës, me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë, në respekt të ligjit dhe rregullave për prokurimin publik.

Për këtë arsye, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin, duke e hequr këtë kërkesë.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “KLAME” SHPK ku kërkon: *Kërkesa që mjetet të jene mbi 1.5 ton është e panevojshme sa kohe në kriteret e vecanta të kualifikimit është kërkuar që operatorët të deklarojnë transportin e mallit me mjetet e tyre. Sipas llogjikës së autoritetit kontraktor, një mjet që mban 1 ton nuk vlen për të realizuar transportin e mallit. Akoma me tej, autoriteti nuk ka hartuar një analizë dhe grafik që do të mbështeste kërkesën e tij, se mjetet duhen patjetër mbi 1.5t, pra, kemi të bëjmë me një kërkesë evazive dhe abuzive.*

III.3.1 Në dokumentet e tenderit, Shtojca 7 “2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT ” autoriteti kontraktor ka parashikuar;

2.3.4 *Operatori ekonomik duhet të disponojë minimum 2 (dy) mjete transporti me peshë mbajtëse mbi 1.5 ton të përshtatshëm për transport mallrash në pronësi, me kontratë qiraje ose forma të tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, me afat kohëzgjatje për të gjithë kohën e vazhdimësisë së kontratës.*

Pronësia e mjeteve të mësipërme vërtetohet:

- *Mjetet në pronësi të shoqërohen me akt pronësie original ose kopje të noterizuara (kontrata shitblerje ose kontrata dhurimi)*

- *Mjetet me qira të shoqërohen me kontratë qiraje si dhe me aktin e pronësisë së qiradhënësit*

- *Për mjetet e transportit duhet të paraqiten edhe dokumentet që vërtetojnë regjistrimin (leje qarkullimi, akt kolaudimi, siguracion, taksat vjetore).*

Shënim: *Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoriteti Kontraktor.*

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit

III.3.2 Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikon shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.3.3 Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se:

1. Qëllim i këtij ligji është:

a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;

b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.3.4 Ndërsa në nenin 3 pika 2 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, thuhet: “2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar”.

III.3.5. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë jenë të detyruar të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me specifikimet teknike/ kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i ofertave nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës.

III.3.6. Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit në tërësi të dokumentacionit të procedurës së prokurimit objekt- ankimi, informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë KPP, konstaton se ky i fundit, në procesverbalin, “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriteret për kualifikim”, në lidhje me pikën 2.3.4 Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Referuar specifikimeve të administruara në dosjen e procedurës është përcaktuar se përveç furnizimit të mallit objekt – prokurimi, do të kryhet transporti dhe vendosja e tyre pranë venddorëzimit të tyre në destinacionin përkates, pra për këtë arsye është e domosdoshme që operatorët e mundshëm ekonomikë të paraqesin dëshmi mbi pajisjet teknike që kanë në dispozicion, për të përmbushur kontratën objekt - prokurimi. Janë kërkuar dy kamionë të përshtatshëm për transport mallrash, për të vërtetuar që ofertuesit pjesëmarrës kanë automjetet e nevojshme për transportin e mallrave, kapacitetet organizative, aftësitë organizative për të zbatuar kontratën, reputacionin dhe besueshmërinë, duke qene se kontrata eshte komplekse me shume artikuj, të cilat duhet të transportohen dhe të bëhet furnizim vendosja e tyre sipas shkollave të përcaktuara.. Përveç kësaj pike, AK ka kërkuar në

pikën 2.3.5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, pranë Autoritetit Kontraktor. Referuar kërkesave sipërcituara, AK si përgjegjës për dokumentacionin e tenderit, duhet të ketë parasysh parimin e proporcionaliteti, bazuar kjo në rëndësinë e procedurës së prokurimit, objektin e kontratës, llojin e mallrave, si edhe sasinë, duke përcaktuar kriteret të thjeshtuara siç është procedura objekt - ankimi, për të lehtësuar punën e operatorëve ekonomikë dhe rritur pjesëmarrjen dhe konkurrencën. Akoma më tej, Komisioni thekson, se është përgjegjësi e operatorëve ekonomikë, që me nënshkrimin e kontratës, të realizojnë procedurën me mjetet e transportit në kohën e duhur sipas afateve të përcaktuara. Me nënshkrimin e kontratës operatori ekonomik është subjekti i parë i interesuar ta realizojë atë në kohë. Operatori ekonomik në ankesën e tij, argumenton qartë pretendimet për modifikim të kriterit 2.3.4., si kriter diskriminues dhe pengues për operatorët ekonomikë. Për sa referuar më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të rishikojë kriterin 2.3.4, duke modifikuar atë në lidhje me tonazhin e mjetit të transportit të mallrave.

Pretendimet e ankimuesit në lidhje me kriterin 2.3.4 qëndrojnë.

III.4 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “KLAME” SHPK, ku kërkon:

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, montimit si dhe vendosjen nëpër vende të të gjithë artikujve në adresat e përcaktuara në planin e shpërndarjes. Për ngjyrat e mobiljeve duhet të kontaktohet paraprakisht Autoriteti Kontraktor.

Kërkesa e mesiperme, që ka të bëjë me caktimin e ngjyrave të mobiljeve në një kohë tjetër është teresisht e paligjshme, pasi jo vetëm që pengon punën për prodhimin e mobiljeve por na le të dyshojmë se e kemi paracaktuar fituesin dhe vetëm ai i di ngjyrat. Ne duam të caktohet qysh në këtë fazë ngjyrat e mobiljeve, pasi afati për realizimin e kontratës është i shkurtër dhe nuk ka kohë të hyjmë në bisedime me vone, pasi na kon përpara vonesave të prodhimit të mallit.

III.4.1 Në dokumentet e tenderit, Shtojca 7 “2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT ” autoriteti kontraktor ka parashikuar;

*2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, montimit, si dhe vendosjen nëpër vende të të gjithë artikujve në adresat e përcaktuara në planin e shpërndarjes. **Për ngjyrat e mobiljeve duhet të kontaktohet paraprakisht Autoriteti Kontraktor.***

III.4.2 Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikon shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.4.3 Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se:

1. Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë eficientë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.4.4 Ndërsa në nenin 3 pika 2 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, , thuhet: “2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar”.

III.4.5. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë jënë të detyruar të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me specifikimet teknike/ kriteret të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi e ofertave nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës.

III.4.6. Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit në tërësi të dokumentacionit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë KPP, konstaton se ky i fundit, ka kërkuar ngjyrat e mobiljeve. “Duhet të kontaktohet paraprakisht”, pra nuk janë përcaktuar ngjyrat e artikujve objekt - prokurimi. KPP vlerëson, se është në të drejtën e autoritetit kontraktor për të përcaktuar kërkesa të cilat nuk ndikojnë në kufizimin e pjesëmarrësve në këtë procedurë prokurimi. Akoma me tej KPP gjykon, se kjo kërkesë është proporcionale, lidhur me procedurën e prokurimit. Me rendësi është fakti që përcaktimi i ngjyrës, mos të ndikojë në preventivin dhe në vlerën e kontratës. Në rast se autoriteti kontraktor arrin ta justifikojë nga studimi i tregut, se përcaktimi i ngjyrës nuk ndikon në preventivin fillestar të procedurës objekt - ankimi, duhet të shprehet duke publikuar shpjegime/ sqarime për operatorët ekonomikë lidhur me këtë fakt.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimmues qëndron pjesërisht.

III.5 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “KLAME” SHPK ku kërkon:

Referuar specifikimeve teknike te publikuara nga ne, asnje pike te tyre te jete pershkruar nese lenda e vete ketij i fundit duhet te jete rezistente ndaj zjarrit, godl si vidat, dorezat etj duhet te permbushin kushtet e rezi etj.

7) Ne mungese te ketyre parashikimeve, autoriteti kontraktor nuk mund le testimi se keshtu ka lexuar diku ne ligji fjalen test dhe apriori i lind e drejta raport testimi.

8) Dispozita ligjore eshte shume e qarte ne kete pike dhe nuk le vend per asnje interpretim apo keqinterpretim. Ajo ka mirepercaktuar se kur mund te kerkohe raport testimi i produkteve dhe kjo kerkese mund te gjeje vend vetem nese autoriteti kontraktor do te vertetoje pajtueshmerine e produkteve me specifikimet teknike. Sic edhe argumentuam, ky nuk eshte rasti qe autoriteti te kerkoje rezultate testimesh sa kohe qe ak nuk ka percaktuar ne specifikimet teknike kushtet teknike te sigurise qe duhet te provohen se permbushen nepermjet testimi zyrtar.

9) Nga ana tjeter, edhe sikur te pranojme se autoriteti kontraktor ka specifikuar kerkesat ne specifikimet teknike (nuk i ka specifikuar) serish ak ka deshtuar te specifikoje se nga cili organ duhet te jete i leshuar ky testim zyrtar, pra nese ai duhet te jete i huaj apo vendas (eshte shume e rendesishme te veme theksin te fakti se referuar faqes Zyrtare te Drejtorise se Pergjitheshme te Standartizimit nuk rezulton qe ne Shqiperi te kete nje subjekt te akredituar per Testimin e Mobilerive apo aksesoreve te tyre). Autoriteti ka anashkaluar faktin se perpara se te arrish te finalizosh nje testim zyrtar si fillim duhet te prodhosh produktin, qe te prodhosh produktin duhet te dish specifikimet teknike per te cilat ne rastin konkret te objektit te prokurimit merret informacion vetem kur ato publikohen ne SPE. Pasi te disponohet ky informacion, vijohet me prodhimin e produktit i cili do kohen e vete pasi askush nuk duhet te hamendesoj se keto produkte mundet te prodhohen per nje dite por duan te pakten disa dite. Pasi te jete prodhuar produkti final i cili duhet te jete sipas specifikimeve teknike te kerkuara nga autoriteti, vijohet me hapin tjeter te dergimit te ketyre produkteve jashte vendit, pasi sic permendem me siper nuk rezulton te kete laborator te akredituar ne Republiken e Shqiperise per testim mobilerish. Te besh nje testim jashte vendit pervec se duhet nje "these" me leke duhet minimalisht 3-4 muaj pasi keta laborator nuk i sherbejne vetem klienteve nga Shqiperia dhe duke i lene menjan shpenzimet per prodhimin, transportin dhe peripecit ne doganat e dy vendeve, serish nuk mjafton afati per ti paraqitur ato ne nje procedure prokurimi ku afati maksimal i mbylles se saj eshte nje muaj.

10) Shoqeria jone gjykon ne cdo rast, se certifikatat e kerkuara duhet te kene lidhje dhe te jene proporcionale me objektin e kontrates, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit

12) Shoqeria jone gjykon se ne percaktimin/apo vendosjen e kriterëve specifike, qe ne thelb konsiderohen si kriterë fituese, per shkak te rendesise qe kane, ligjvenesi i ka parashikuat kufizime autoritetëve kontraktore brenda diskrecionit qe ka ne perzgjedhjen e tyre. Ne kete menyre, dispozitat e siperpermendura, urdherojne se percaktimi i ketyre kriterëve duhet te jete: "(i) duke krijuar kushte dhe duke lene afat te arsyeshem per t'u pajisur me keto certifikime (ii) proporcional me objektin e prokurimit dhe (iii) duke respektuar parimin e mosdiskriminimit.

13) Ne interpretimin teleologjik (qellimit) te dispozites se sipercituar, gjykojme se, qellimi i vendosur nga ligjvenesi, eshte dhenia e mundesise se autoritetit kontraktor, i cili eshte pergjegjes per prokurimin e fondeve publike te kryerjes se verifikimeve (ekzaminim, inspektim, testim) nga autoriteti kontraktor te mostrave te dorezuara, ne rast se keto te fundit jane ne perputhje me kerkesat e autoritetit kontraktor te pasqyruar ne specifikimet teknike te procedures se prokurimit objekt ankimi

14) Ligjvenesi ka kufizuar te drejten e autoritetit kontraktor mbi vendosjen e kriterit te mesiperme te kualifikimit ne respekt te parimit te proporcionalitetit, si nje parim gjithperfishires ne ligjin e prokurimit publik, duke e lidhur vendosjen e kriterit strictu sensu me rendesine qe ka per vleresimin nese kushtet teknike te sigurise te vendosura ne specifikimet teknike (nuk jane vendosur) provohen se permbushen nepermjet testimi zyrtar ne kuptim te pikes 6 te nenit 40 te VKM-se nr. 285.

15) Sa me siper, ne vleresimin e proporcionalitetit te kerkeses se autoritetit kontraktor mbi

dorezimin e testeve per disa nga produktet duhet pare ne interpretim te zgjeruar me rendesine qe ka dorezimi i testeve per te vleresuar nese kushtet e sigurise te pasqyruara ne specifikimet teknike (nuk jane pasqyruar) provohen se permbushen nepermjet testimit. Ne vleresimin ligjor ne rast se kerkesa e mesiperme e autoritetit kontraktor ze peshen me te madhe, rendesine me te madhe, apo pa plotesimin e ketij kushti, autoriteti kontraktor nuk mund te realizoje qellimin e tij final ne vleresimin nese kushtet e sigurise te pasqyruara ne specifikimet teknike (nuk jane pasqyruar) provohen se permbushen nepermjet testimit, shoqeria jone gijkon se duhet interpretuar ne teresi neni 40 pika 6 i VKM 285.

16) Ne rastin konkret, gijkojme, se synimi i autoritetit kontraktor lidhet drejtperdrejte me verifikimin e perputhshmerise se specifikimeve teknike te produkteve te ofruara nga operatoret ekonomike pjesemarres, me ato te kerkuara nga autoriteti kontraktor ne dokumentet e tenderit. Per kete vleresim, shoqeria jone konstaton, se autoriteti kontraktor ka kerkuar nje sere dokumentacioni, duke nisur nga: • certifikatat qe vertetojne se ofertuesi/prodhuesi i produkteve eshte i certifikuar sipas standardit nderkombetar ISO 9001-2015, ISO 14001-2015, ISO 45001-2018 de BS PAS 99:2012; • garancia e mallrave do te jete jo me pak se 1 vit nga data e dorezimit te artikujve objekt prokurimi), gjate se ciles ofertuesi do te siguroje riparimin, mirembajtjen dhe sherbimin pa pagese, te defekteve per shkak te prodhimit dhe montimit tyre; • disponimi dhe paraqitja e certifikatave te cilesise se produktit SSH/EN te vlefshme, per artikujt si me poshte: V Karrige zyre statike: SSH/ EN 1335-1:2020+41:2022, SSH EN 1335-2:2018 e vlefshme ose ekuivalente r Karrige rrotulluese (eyre): SSH/ EN 1335-1:2020+47: 2022, SSH EY 4325: 2:30188. k. vlefshme ose ekuivalente.

Dollap (Raft) : SSH/ EN 14073-1:2004, EN 14073-3:2004, SSH EN 14074:2004, e vlefshme ose ekuivalente. Dollap metalike: SSH/ EN 14073-3:2004, EN 14074:2004, e vlefshme ose ekuivalente. • Kerkesa per paraqitjen e mostrave ditën dhe oren e hapjes se ofertave;

17) Me ane te dokumentacionit te mesiperme te kerkuar, ne gijkojme se autoriteti kontraktor mund te investigoje, krahasoje ne menyre te plote mbi perputhshmerine e produkteve te ofruara me ato te kerkuara.

18) Kerkesa e autoritetit nuk i sherben qellimit per arsye se edhe ata operator ekonomik qe mund ti kene raportet e testimi per tavolina apo dollape, serish nuk i kane ne menyre koncize sipas permasave dhe specifikave teknike per ato dollape apo tavolina qe i duhen kesaj procedure ose nese ata i kane ateherë i bie qe keta kane pasur informacion paraprak per specifikimet teknike ku keto te fundit i'u jane dhene perpara se te publikohej procedura e prokurimit, cka do te bente shkelje te barazise se tenderave ne kuptim te Kodit Penal te Rep se Shqiperise.

19) Ne vijim te sa me siper, sa kohe eshte kerkuar qe shoqeria te jete e certifikuar sipas standardeve te referuara me siper, kjo verteton pajtueshmerine e materialeve te prodhuara me standardet e kerkuara dhe kerkesa edhe per testimi raporti eshte nje dublim i kerkesave.

20) Duke marre shkas nga natyra e mallrave per te cilat kerkohet dorezim i mostrave perkatese nga ana e autoritetit kontraktor, shoqeria jone konstaton se keto te fundit shfaqen ne cilesine e produktit final dhe anjehere te lendes se pare per perfitimin e produktit final e njeherazi kontrolli me perpara (ex-ante) i perputhshmerise se specifikimeve teknike me kerkesat e autoritetit kontraktor shfaqet shume i thieshte per t'u realizuar dhe synimi i autoritetit kontraktor permbushet edhe me ane te dokumentacionit te mesiperme te kerkuar nga ky i fundit me ane te cilave kontrollohet edhe perputhshmeria e specifikimeve teknike te produkteve te ofruara. Sa me siper, duke u nisur edhe nga natyra e mallrave te kerkuar nga autoriteti kontraktor, shoqeria jone, gijkon se, kerkesa mbi dorezimin e testeve te sipercituara nuk eshte e rendesishme per vleresimin e ofertes teknike ne kuptim te nenit 40 pika 6 germa te VKM nr.285 date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndry shuar.

21) Akoma me tej, autoriteti kontraktor ka ne dispozicion edhe momentin procedural te kontrollit te dyte pas lidhjes se kontrates te perputhshmerise te produkteve te furnizuara nga operatori ekonomik i kualifikuar, me ato te kerkuara nga autoriteti kontraktor. Sqarojme, se ne baze te nenit 124 "Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gate zbatimit te kontrates" te LPP, autoriteti kontraktor ka nje rol te posaçem, per vetecilesimin e tij ligjor, si autoriteti me interes

dhe pergjegjesi thelbesore per realizimin e suksesshem te kontrates. Sjellim ne vemendje te autoritetit kontraktor, se referuar rregullave te prokurimit publik, eshte pikerisht autoriteti kontraktor ai qe duhet te monitoroje zbatimin e kontrates, per t' u siguruar nese cilesia e mallit do te jete e nejte me cilesine dhe specifikimet teknike te premtuara ne oferte dhe te percaktuara ne kontrate. Per te gjitha arsyet qe permendem me siper, shoqeria jone gjykon se kerkesa e mesiperme e autoritetit kontraktor nuk eshte proporcionale me objektin e procedures se prokurimit, natyren, permaset e kontrates, si edhe me qellimin e kerkuar nga vete autoriteti kontraktor. Sa me siper, autoriteti kontraktor duhet te beje modifikimet perkatese duke hequr kriterin e mesiperm per paraqitjen e "Raportit te Testimit".

III.5.1 Në dokumentet e tenderit, shtojcën e publikuar lidhur me ndryshimin e dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor ka parashikuar;

Pika 2.3.11 Bëhet:

2.3.11 Operatori ekonomik duhet të disponojë dhe paraqese certifikatat e cilësisë dhe raportet e testimi të produktit, të vlefshme, si më poshtë:

- Karrige zyre statike: SSH/ EN 1335-1:2020+A1:2022, SSH EN 1335-2:2018 e vlefshme ose ekuivalente*
- Karrige rrotulluese (zyre): SSH/ EN 1335-1:2020+A1:2022, SSH EN 1335-2:2018,e vlefshme ose ekuivalente.*
- Dollap (Raft) : SSH/ EN 14073-1:2004, EN 14073-3:2004 , SSH EN 14074:2004, e vlefshme ose ekuivalente.*
- Dollap metalik: SSH/ EN 14073-3:2004, EN 14074:2004, e vlefshme ose ekuivalente.*

Certifikatat e cilësisë së produktit duhet të jenë të vlefshme në momentin e dorëzimit dhe të hapjes të ofertave të procedurës së prokurimit. Certifikatat e kërkuara duhet të jenë origjinale ose të njehsuara me origjinalin (kopje e noterizuar). Certifikatat e cilësisë duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet kur oferta dorëzohet nga një BOE, operatorët duhet të disponojnë certifikatat e kërkuara në përputhje me raportin e pjesëmarrjes në furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje.

Gjithashtu, për të gjitha certifikatat e mësipërme, operatori ekonomik mund të paraqesë certifikata ekuivalente me të njëjtën performancë (qellim certifikues) ose të përditësuara me ato më sipër, sipas standardeve SSH/EN mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Shënim: Operatori ofertues, së bashku me dokumentacionin e sipërshënuar, duhet të paraqesë të dhëna të plota të Subjektit që lëshon certifikatat e cilësisë dhe raportet e testimi të produktit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e ti.

III.5.2 Autoriteti kontraktor në shtojcën e publikuar lidhur me "Procesverbal Argumentimi të Dst Mobilje 2024.", ka argumentuar lidhur me kërkesën e mesiperme si më poshtë:

Argumentim: *Në bazë të pikës 1 dhe 2, të nenit të 79, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 44, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar.*

Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t' u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Këto kërkesa janë të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimi dhe ka të bëjë me

testet funksionale, të përshtatshmerisë të funksionalitetit dhe të qëndrueshmerisë gjatë përdorimit.

Karrige zyre statike: SSH/ EN 1335-1:2020+A1:2022, SSH EN 1335-2:2018 e vlefshme ose ekuivalente, standard që përcakton dimensionet funksionale të **Karrige zyre statike** për përdorim në ambientet e zyrave postare, standard që përdoret për kërkesat e sigurisë, forcës dhe qëndrueshmerisë për karriget e punës në zyrë. Nuk zbatohet për vendet e tjera në zonën e zyrës për të cilat ekzistojnë standarde të tjera evropiane. Kërkesat bazohen në përdorimin për 8 orë në ditë nga persona që peshojnë deri në 110 kg. Shtojca A (informative) përmban ngarkesat, masat dhe ciklet për testet funksionale. Një certifikatë e tillë nënkupton që produkti është i sigurtë për një përdorim të tillë.

• **Karrige rrotulluese (zyre): SSH/ EN 1335-1:2020+A1:2022, SSH EN 1335-2:2018, e vlefshme ose ekuivalente**, standard që përdoret për të përcaktuar kërkesat në lidhje me dimensionet që duhet të ketë një karrige zyre për përdorim të zakonshëm në mënyrë që të sigurohet një qëndrim i përshtatshëm për të punuar dhe gjithashtu përshkruan edhe metodat e testimeve të kryera për përcaktimin e tyre. Një certifikatë e tillë nënkupton që produkti i prodhuar respekton keto dimensione.

SSH EN 1335-1:2020+A1:2022, SSH EN 1335-2:2018, standard që specifikon kërkesat që duhet të plotësojnë këto karrige për sa i përket sigurisë, forcës dhe qëndrueshmerisë për një përdorim rreth 8 orë në ditë dhe për një person që peshon deri në 110 kg. Një certifikatë e tillë nënkupton që produkti është i sigurtë për një përdorim të tillë.

Këto standarde shoqërohen bashkë. Një certifikatë e tillë nënkupton që mobilja e prodhuar i plotëson këto standarde.

Dollap (Raft) : SSH/ EN 14073-1:2004, EN 14073-3:2004 , SSH EN 14074:2004, e vlefshme ose ekuivalente. standard që specifikon kërkesat e sigurisë për mobiljet e ruajtjes së zyrës, metodat e provës për përcaktimin e forcës së strukturës së mobiljeve të zyrës me qëndrim të lirë, si dhe qëndrueshmërinë e njësisë të lira.

SSH/ EN 14073-1:2004, EN 14073-3:2004 , SSH EN 14074:2004, standard që përdoret për të përcaktuar kërkesat në lidhje me **përcaktimin e forcës dhe qëndrueshmërisë së pjesëve lëvizëse të Dollapit (Raft)**. në mënyrë që të sigurohet përballimin e një përdorimin normal funksional, si dhe keqpërdorimet që mund të priten në mënyrë të arsyeshme të ndodhin.

Ky standard evropian specifikon kërkesat e sigurisë, forcës dhe qëndrueshmërisë në **Dollap (Raft)**.

Dollap metalike: SSH/ EN 14073-3:2004, EN 14074:2004, e vlefshme ose ekuivalente.

Standard që specifikon kërkesat e sigurisë për Dollap metalike, metodat e provës për përcaktimin e forcës së strukturës së mobiljeve të zyrës me qëndrim të lirë, si dhe qëndrueshmërinë e njësisë të lira.

SSH/ EN 14073-3:2004, EN 14074:2004, standard që përdoret për të përcaktuar kërkesat në lidhje me **përcaktimin e forcës dhe qëndrueshmërisë së pjesëve lëvizëse të Dollapit metalik**, në mënyrë që të sigurohet përballimin e një përdorimin normal funksional, si dhe keqpërdorimet që mund të priten në mënyrë të arsyeshme të ndodhin.

Ky standard evropian specifikon kërkesat e sigurisë, forcës dhe qëndrueshmërisë në **Dollapit metalik**.

III.5.4 Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në mënyrë elektronike në SPE nga autoriteti kontraktor, Komisioni konstaton, se në procesverbalin përkatës për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, autoriteti kontraktor nuk ka bërë asnjë argumentim lidhur me kriterin për kualifikimin, përkatesisht për kërkesën mbi "RAPORT

TESTIMI” , çka është në kundërshtim me përcaktimet në pikën 2 të nenit 78 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “*Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktohet i një specialisti fushe, hartimi i kërkesave si më sipër bëhet nga njësia e prokurimit. Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit. Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga anëtarët e njësisë së prokurimit*”. Sa më sipër, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor referuar procesverbalit të argumentimit të kriterëve, në asnjë rast nuk ka argumentuar teknikisht pse është i domosdoshm për AK disponimi i raport - testimi.

Gjithashtu, autoriteti kontraktor nuk ka dhënë asnjë argument dhe nuk ka justifikuar se në cilat standarde është mbështetur në hartimin kësaj kërkesë.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret në lidhje me artikujt objekt-prokurimi, por në çdo rast këto kriteret duhet të jenë në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës që prokurohet, si dhe duhet të jenë të justifikuar teknikisht, bazuar në fakte dhe prova konkrete, pasi vendosja e kriterëve për kualifikim joproporcionale dhe të pajustificuara, shkakton kufizime dhe përjashtime tërësisht të panevojshme nga pjesëmarrja në procedurë e operatorëve ekonomikë të interesuar. Ndaj KPP gjykon, se autoritetet kontraktore duhet të shmanin çdo kriter, apo kërkesë që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim. Qëllimi i autoritetit kontraktor duhet të jetë nxitja e pjesëmarrjes së ofertuesve në procedurën e prokurimit, si dhe rritja e konkurrencës ndërmjet ofertuesve, për të siguruar ofertën më të sukseshme, që plotëson nevojat e autoritetit kontraktor me kosto më të ulët.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qendrojnë.

III.6 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “KLAME” SHPK, se:

Kerkesa që krahas vertetimit të realizimit me sukses të kontratës të paraqiten edhe faturat tatimore është një kërkesë e dubluar, pasi nëse paraqesim vertetimin që jep informacion për objektin, vlerën e realizuar dhe datat e realizimit nuk ka nevojë të paraqiten edhe faturat, pasi kjo thjesht sa do krijojë pengesa dhe barriera artificiale që nuk çojnë askund. Vertetimi jep informacionin që i nevojitet autoritetit kontraktor dhe duhet të kufizohet vetëm në të ose të kerkoie vetëm fatura. 7) Kerkesat kufizohen vetëm në ato që janë të pershtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kerkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. Për këto arsye kërkojmë që në kriter të lihet vertetimi ose faturat, por jo të dyja.

III.6.1 Në dokumentet e tenderit, Shtojcën 7, autoriteti kontraktor ka përcaktuar :

2.3.1. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39% të vlerës së përllogaritur fondit limit që prokurohet.*

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- *për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas*

kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara, - për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

III.6.2 Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020, “Për prokurimin publik”, parashikon shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.6.3 Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se:

1. Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.6.4 Ndërsa në nenin 3 pika 2 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, thuhet: “2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar”.

III.6.5 Referuar VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, ”PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK”, e ndryshuar përcaktohet se :

Neni 40

Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave

4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

III.4.5. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje

me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me specifikimet teknike/ kriteret të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i ofertave nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës.

III4.6. Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit në tërësi të dokumentacionit të procedurës së prokurimit objekt- ankimi, informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë KPP, konstaton, se ky i fundit ka kërkuar, që operatori ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi të paraqesë vërtetime për përvojën e mëparshme të ngjashme. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetime të mëparshme të realizuara me sektorin publik, ku ky i fundit duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara, dhe për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi. Referuar VKM nr. 285, datë 19.5.2021 ”PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK” i ndryshuar, është përcaktuar “Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara”. KPP vëren, se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor, përkatësisht kriteri 2.3.1, nuk është në kundërshtim me ligjin, pasi ligjvënësi e ka lënë të hapur, në zgjedhje të vetë autoritetit kontraktor, kërkesën mbi diponimin si të vërtetimeve, ashtu dhe të faurave. KPP gjykon, se duke pasur parasysh natyrën, objektin dhe volumin e kontratës, përcaktimi i bërë nga autoriteti kontraktor lidhur me këtë kriter, është në proporcion dhe është i lidhur ngushtë me objektin e kontratës, me vlerën dhe objektivat e saj.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Për sa më sipër në mbështetje të nenit 30 dhe pikat 1 dhe 2 të nenit 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik

gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen, për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “KLAME” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-96233-02-23-2024, me objekt: “Blerje Pajisje Mobilimi”, me fond limit 28,841,800.00 lekë (pa TVSh), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 13.03.2024, nga autoriteti kontraktor, Sh.A Posta Shqiptare.
 2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “KLAME” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.
 3. Autoriteti kontraktor, të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
 4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
 5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “KLAME” SHPK.
 6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.
 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

